

UDHËZIM
Nr. 7, datë 31.3.2026

**PËR PËRGATITJEN DHE PUBLIKIMIN E RAPORTIT TË DEVIJANCAVE TË
PARASHIKIMEVE MAKROEKONOMIKE, FISKALE DHE BUXHETORE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 57, datë 2.6.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”, ministri i Financave:

UDHËZON:

I. TË PËRGJITHSHME

a) Ky udhëzim përcakton kriteret, formatet dhe afatet për hartimin dhe publikimin e raportit mbi devijimet ndërmjet parashikimeve makroekonomike dhe fiskale për vitin t , të ardhurave dhe shpenzimeve të miratuara në ligjin e buxhetit për vitin t , dhe parashikimeve të përcaktuara në Kuadrin Makroekonomik dhe fiskal të miratuar në janar të çdo viti për vitin t ;

b) Dokumentet zyrtare të cilat do të përdoren për përllogaritjen e këtyre devijancave janë:

- Kuadri makroekonomik dhe fiskal i miratuar në janar për vitet, t , $t+1$, $t+2$, dokumenti që drejton kuadrin buxhetor afatmesëm;

- Ligji vjetor i buxhetit të shtetit për vitin t .

Për parashikimet makroekonomike dhe fiskale afatmesme të cilat nuk janë të publikuara si pjesë e ligjit vjetor të buxhetit, do të përdoret si dokument referues paketa shoqëruese e projektligjit vjetor të buxhetit.

a) Raporti i devijancave duhet të përmbajë dhe një analizë të përputhshmërisë me rregullat fiskale të përcaktuara në ligjin nr. 57/2016, “Për ligjin organik të buxhetit”, veçanërisht për:

- Balancën primare;

- Nivelin e borxhit publik;

- Deficitin buxhetor në raport me madhësinë e shpenzimeve kapitale.

II. KRITERET PËR PËRLLOGARITJEN E DEVIJANCAVE DHE FORMATI I RAPORTIMIT

a) Për qëllimet e këtij udhëzimi, devijimet e parashikimeve makroekonomike do të përfshijnë, por nuk kufizohen në treguesit:

1. Objektivi i Balancës Buxhetore (si përqindje ndaj PBB-së);

2. Objektivi i Balancës Primare (si përqindje ndaj PBB-së);

3. Stoku i Borxhit Publik (si përqindje ndaj PBB-së).

Çdo devijim nga kuadri afatmesëm buxhetor duhet të shoqërohet me një shpjegim analitik të detajuar të faktorëve ekonomikë, fiskalë ose faktorëve të tjerë relevantë që kanë shkaktuar këtë devijim;

b) Devijancat e të ardhurave duhet të përfshijnë:

1. Grantet;

2. Të ardhurat nga taksat dhe doganat, dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

3. Të ardhurat nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

4. Të ardhurat jotatimore.

Për çdo devijim të parashikimit të të ardhurave në ligjin vjetor të buxhetit krahasuar me parashikimin e janarit, burimet e devijimit (performanca fiskale, ndryshimet ligjore, faktorët

ekonomikë etj., sipas urdhrit të ministrit të Financave nr. 61, datë 8 prill 2025, për miratimin e Dokumentit Standard mbi parashikimin dhe planifikimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit), duhet të specifikohen dhe analizohen për secilin lloj të ardhure të përmendur në pikën “b”;

c) Për qëllimet e këtij udhëzimi, devijimet e parashikimeve të shpenzimeve do të përfshijnë, por nuk kufizohen në zërat:

1. Shpenzimet e personelit;
2. Shpenzimet operative dhe mirëmbajtjen;
3. Subvencionet;
4. Fondet speciale;
5. Buxhetin e qeverisjes vendore;
6. Shpenzimet kapitale;
7. Shpenzime të tjera.

Çdo devijim i shpenzimeve për zëra 1–7 nga parashikimet e kuadrit makroekonomikë dhe fiskal, duhet të shpjegohen dhe shoqërohet me referencat e politikave që ato prekin;

d) Raporti i devijimeve duhet të përfshijë, por të mos kufizohet në:

- Një tabelë krahasuese të treguesve të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe atyre të parashikuar në janar që janë pjesë e kuadrit afatmesëm buxhetor;

- Një analizë narrative për çdo devijim të identifikuar;

- Një analizë të ndikimit të këtyre devijimeve në objektivat fiskale afatmesme të përcaktuara në kornizën makrofiskale.

III. STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE ROLI I TYRE

a) Struktura përgjegjëse për parashikimet makroekonomike analizon dhe përgatit raportin e devijimeve për treguesit makroekonomikë.

b) Struktura përgjegjëse për parashikimet fiskale analizon dhe përgatit raportin e devijimeve për të ardhurat tatimore qendrore.

c) Strukturat përgjegjëse për planifikimin e buxhetit, financat vendore dhe menaxhimin e investimeve publike analizojnë dhe përgatisin raportin e devijimeve për të ardhurat nga ndihma, të ardhurat jotatimore, të ardhurat vendore dhe shpenzimet buxhetore.

d) Raporti i konsoliduar i devijimeve përgatitet nga struktura përgjegjëse për planifikimin e buxhetit dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave brenda muajit janar të çdo viti.

e) Përjashtimisht për vitin 2025, raporti i devijancave do të publikohet brenda muajit prill 2026.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCave

Petrit Malaj